



Reflektimi për javën time të parë si kancelar

Të nderuar familjarë dhe kolegë,

Java e kaluar, e para për mua si kancelar i shkollave publike të qytetit të Nju-Jorkut, ishte energjike dhe emocionalisht e fuqishme. Vizitova shkolla në të pesta bashkitë dhe takova nxënësit, stafin, familjet dhe anëtarët e komunitetit - dhe idetë dhe reflektimet e tyre vazhdojnë të më frymëzojnë.

Të hënën e kaluar, vizitova klasat në PS/MS 194 në Bronx, shkolla ku dhashë mësim në fillim të viteve 2000. Më pritën disa fytyra të njohura, duke përfshirë ish-nxënësin tim Abdulla, i cili ndaloj vetëm për këtë vizitë. Prania e tij ishte veçanërisht e rëndësishme. Kur Abdullahi ishte nxënës, ai nuk kishte gjithmonë ndjesi të fortë përkatësie në shkollë. Në atë kohë, u përpoqa ta trajtoja këtë problem duke luajtur futboll dhe duke vrapuar në gara me të. Siç më tregoi gjatë vizitës sonë, ato momente të vogla e ndihmuan të ndihej i vlerësuar dhe i kuptuar.

Kjo përvojë vazhdon të ndikojë në mënyrën se si mendoj për punën tonë sot. Jam i përkushtuar të drejtoj një sistem që i jep përparësi mbështetjes së nxënësve, ambienteve edukuese dhe mësimdhënies me cilësi të lartë dhe që i përgjigjet nevojave kulturore. Si profesionist arsimit dhe udhëheqës i NYCPS-së për më shumë se 20 vjet, dhe si prind krenar i dy nxënësve të NYCPS-së, besoj se çdo fëmijë meriton shkolla të sigurta, akademikisht rigorozë dhe vërtet të

integruara. Mund të mësoni më shumë rreth këtyre fushave të fokusit në [mesazhin tim të fundit drejtuar familjeve](#).

Pres me padurim të bashkëpunoj me ju ndërsa i përgatisim nxënësit tanë (si Abdullahi, i cili tani po shkëlqen në karrierën e tij!) për një të ardhme të ndritur dhe të suksesshme.

Në bashkëpunim,

Kamar H. Samuels
Kancelar (Chancellor)

Për lajme dhe burime shtesë, vizitoni [The Morning Bell](#) ose ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#) dhe [YouTube](#).

Familje të NYCPS-së: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, [çaktivizoni abonimin](#).